



Departamenti i Mbiqëqyrjes së Tregut të Sigurimeve

**Departamenti i Mbiqëqyrjes së Tregut të Kapitaleve
dhe Fondeve**

**Analizë mbi përdorimin e monedhës kombëtare në tregjet
financiare, nën mbikëqyrjen e Autoritetit të Mbiqëqyrjes
Financiare (Janar-Qershor 2021)**

Gusht 2021

Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
I. Hyrje.....	3
II. Përdorimi i monedhave të huaja sipas tregjeve.....	4
A. Tregu i sigurimeve.....	4
1. Informacion mbi primet e shkruara bruto	4
2. Informacion mbi depozitat bankare të shoqërive të sigurimit	6
B. Tregu i Kapitaleve	11
1. Tregu me pakicë	11
2. Bursa Shqiptare e Titujve	12
3. Obligacionet me ofertë private	13
C. Tregu i Fondeve të Investimit dhe të Pensioneve.....	14
III. Përfundime	15

I. Hyrje

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Banka e Shqipërisë nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare” në muajin prill të vitit 2017, ku angazhohen të ndër marrin veprime për të ulur nivelin e përdorimit të monedhave të huaja në ekonomi sipas sektorëve të cilët mbikëqyrin, monitorojnë apo operojnë në aktivitetin e tyre.

Duke qenë se në vendin tonë është krijuar një traditë e përdorimit të gjerë të monedhave të huaja (valutat), kryesisht të Euros dhe dollarit amerikan, masat që duhet të ndërmerren për minimizimin e përdorimit të monedhave të huaja duhet të jenë të kujdesshme dhe të argumentuara, për të qenë efektive.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (më tej, Autoriteti) monitoron me kujdes përdorimin e monedhave të huaja në tregjet financiare nën mbikëqyrje. Lidhur me veprimtarinë në valutë, në këtë raport janë përfshirë:

Informacion për tregun e sigurimeve sipas produkteve dhe investimeve nga shoqëritë, informacion për fondet e investimeve dhe të pensioneve vullnetare private. Disa nga produktet financiare të këtyre institucioneve, operojnë në valutë për arsye objektive.

Të tillë janë, për shembull disa produkte të sigurimit të detyrueshëm motorik, si polica kufitare dhe Kartoni Jeshil. Produkti i Kartanit Jeshil është produkt ndërkombëtar sigurimi, i cili lëshohet në monedhën Euro, pasi edhe detyrimet që i linden shoqërisë së sigurimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për pagesë dëmshpërblimi nga ky sigurim janë në Euro. Polica kufitare lëshohet në pikat e kalimit kufitar gjatë hyrjes së automjeteve me targa të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe pagesa e primit të policës në monedhën vendase do të vështirësonte procesin e pajisjes së konsumatorit me këtë policë sigurimi. Po kështu, disa nga produktet kryesore të aktivitetit të sigurimit, si sigurimi i pronës me përfitues bankat tregtare ose sigurimi i Jetës së debitorit, janë të lidhura ngushtësisht me monedhën e kredisë. Monedha në të cilën disbursohet kredia dikton dhe monedhën e lëshimit të policës, për shkak të nevojës për të rikuperuar në të njëjtën monedhë vlerën e detyrimit, në rastin e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

Tek fondet e investimit, në disa prej tyre, natyra e profilit të veprimtarisë kërkon investimin e tyre në aksione apo tituj të tregjeve ndërkombëtare, pra realizohet në valutë. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2021 vihet re një rënie në peshën specifike të asetëve neto të fondeve të investimit në monedhë të huaj.

II. Përdorimi i monedhave të huaja sipas tregjeve

A. Tregu i sigurimeve

1. Informacion mbi primet e shkruara bruto

Referuar të dhënave për 30.06.2021, primet e shkruara bruto¹ rezultojnë për të gjithë aktivitetin e tregut të sigurimeve Jo-Jetë dhe Jetë në rreth 8.9 miliardë lekë. Rreth 31% e tyre është realizuar në monedhën Euro.

Në mënyrë të detajuar, vihet re se përveç produkteve të detyrueshme të Kartonit Jeshil dhe Sigurimi Kufitar, ka edhe disa produkte vullnetare që rezultojnë me të ardhura pothuajse 100% të realizuara në Euro, siç është Sigurimi i Aksidenteve dhe Shëndetit, Sigurimi i Jetës në Udhëtim dhe Sigurimi i Jetës së Studentit. Gjithashtu, produktet që shfaqin një vlerë të primeve të shkruara në përqindje të lartë në Euro janë: Sigurimi Kasko, Sigurimi i Pronës, Sigurimi Inxhinierik, si: Sigurimi i të Gjitha Risqeve në Ndërtim (CAR)² në aktivitetin e sigurimit Jo-Jetë dhe Sigurimi i Jetës me Kursim dhe “Flexi Plan” për Sigurimin e Jetës. Ndërkohë, produktet si Sigurimi i Mallit në Transport apo Sigurimet Inxhinierike paraqesin një nivel të lartë Euroizimi për shkak të interesit të siguruar nga këto kontrata, interes i cili vlerësohet kryesisht në Euro në rastet e import-eksporteve dhe sigurimeve inxhinierike që përfshijnë vepra madhore të infrastrukturës, përfshirë ato me shoqëri ndërkombëtare.


Referuar grafikut 1, në 30.06.2021 pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt totalit për aktivitetin e Sigurimit Jo-Jetë ka pësuar një rritje me 5% krahasuar me fundvitin 2020 (31% nga 26%). Edhe pse brenda strukturës së klasave të sigurimit ka patur disa ndryshime, nuk ka patur efekt në peshën totale të primeve të shkruara në Euro kundrejt totalit për aktivitetin e Sigurimit Jo-Jetë.

Siç vërehet në grafikun e mëposhtëm, në 30.06.2021, klasat që kanë shfaqur rënie më të theksuar të primeve të shkruara në Euro në krahasim me 31.12.2020, janë: Sigurimi i Aksidenteve dhe Shëndetit, me rënie të peshës me 5% (nga 61% në 56%), pasuar nga Sigurimi i Mallit në Transport, me rënie me 4% (nga 69% në 65%). Ndërkohë, rëniet në peshë të klasave të sipërpërmendura në 30.06.2021 janë balancuar kryesisht nga rritja e peshës së primeve të shkruara bruto në Euro kundrejt totalit të primeve të shkruara në krahasim me 31.12.2020, për: Sigurime të Aviacionit me rritje të peshës me 100% (nga 0% në 100%), Sigurimin e Garancive me rritje të peshës me 7% (nga 16% në 23%), Sigurimin e Pronës me rritje të peshës me 6% (nga 53% në 59%) dhe Sigurimin e Përgjegjësisë Civile me rritje të peshës me 4% (nga 45% në 49%).

¹ Primet e shkruara bruto janë të ardhura për shoqëritë e sigurimit dhe si të tilla, këto dy terma përdoren në këtë material si zëvendësues të njëri-tjetrit.

² Produkt Sigurimi Jo-Jetë, i cili ofron mbulimin me sigurim nga të gjitha rreziqet për fazën e ndërtimit të objekteve dhe gjithashtu edhe për një afat garancie pas përfundimit të punimeve.

Grafik 1: Pesha e primeve të aktivitetit të sigurimit Jo-Jetë në EUR kundrejt totalit




Referuar grafikut të mëposhtëm, në 30.06.2021, pesha e primeve të shkruara në Euro kundrejt primeve të shkruara bruto në total për aktivitetin e Jetës ka shënuar një rënie me 3%, duke arritur në 34%, nga 37% që ka qenë në 31.12.2020.

Siç vërehet në grafikun e mëposhtëm, në 30.06.2021, klasat që kanë shfaqur rënien më të theksuar të primeve të shkruar në Euro në krahasim me 31.12.2020, janë: Sigurimi “Cash Plan”, me rënie të peshës me 49% (nga 62% në 13%), për shkak të sezonalitetit që karakterizon zhvillimin e shitjeve apo rinovimeve të kontratave në lidhje me këtë produkt, ndjekur nga Sigurimi i Jetës me Elementë të Ndryshueshëm ose “Flexi Plan”, me rënie të peshës me 4% (nga 69% në 65%) dhe Sigurimin e Jetës së Debitorit³ me 4% (nga 27% në 23%). Ndërkohë, rëniet në peshë të klasave të sipërpërmenduar në 30.06.2021 janë tajkaluar kryesisht nga rritja e peshës së primeve të shkruara bruto në Euro kundrejt totalit të primeve të shkruara bruto në krahasim me 31.12.2020, për: Sigurimin e Kombinuar të Jetës⁴ me rritje të peshës me 11% (nga 33% në 44%) dhe Sigurimin e Jetës së Studentit me 33% (nga 32% në 65%).

³ Produkt Sigurimi Jete, i cili mbulon rrezikun e mos shlyrjes së hua-së, si pasojë e humbjes së jetës së huamarrësit.

⁴ Produkt Sigurimi Jete, i cili kombinon sigurimin e jetës dhe sigurimin ndaj sëmundjeve kritike.

Grafik 2: Pesha e primeve të aktivitetit të Jetës në EUR kundrejt totalit



2. Informacion mbi depozitat bankare të shoqërive të sigurimit

Depozitat e shoqërive të sigurimit për periudhën 30.06.2021, të investuara në monedhat Lekë dhe valutë të huaj, rezultojnë në vlerë totale rreth 12 miliardë Lekë.


Nga këto depozita në monedhën vendase Lekë janë investuar rreth 6 miliardë Lekë, ose rreth 50% e totalit të depozitave, ndërsa ato në valutë rezultojnë të jenë gjithashtu rreth 6 miliardë Lekë, ose rreth 50% e vlerës totale të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat zënë rreth 85.5% të depozitave totale në valutë dhe 43.1% të depozitave totale. Pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Kundrejt fundit të vitit 2020, depozitat në valutë shënojnë një rritje të lehtë në vlerë dhe në peshë ndaj totalit të depozitave të shoqërive të sigurimit.


Në mln Lekë

	Depozita në Lekë		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2020	30.06.2021	31.12.2020	30.06.2021	31.12.2020	30.06.2021
TREGU TOTAL	6,247	5,974	791	881	4,965	5,194

Grafik 3: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve në total



Grafik 4: Pesha e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave



a) Tregu i sigurimeve Jo-Jetë


Përsa i përket tregut të sigurimit Jo-Jetë, për periudhën 30.06.2021, 4.3 miliardë Lekë janë investuar në depozita në Lekë, ose rreth 46.5% kundrejt totalit të depozitave, ndërsa 4.9 miliardë Lekë janë investuar në depozita në valutë, ose rreth 53.5% kundrejt totalit të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat kapin vlerën rreth 34.1 milionë Euro, ose kundravlerën rreth 4.2 miliardë Lekë dhe zënë rreth 84.3% të depozitave totale në valutë dhe 45.1% të depozitave totale. Pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Kundrejt fundit të vitit 2020, depozitat në valutë kanë shënuar rritje ndaj totalit të depozitave me 2.8%. Pesha e depozitave në Euro ndaj totalit të depozitave është rritur me 2.2%, kjo jo vetëm për arsye të shtimit të depozitave në Euro, por edhe si pasojë e pakësimit të depozitave në Lekë. Ndërkohë pesha e Euro-s në depozitat në valutë është ulur lehtësisht.


Në mln Lekë

	Depozita në Lekë		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2020	30.06.2021	31.12.2020	30.06.2021	31.12.2020	30.06.2021
TREGU JO-JETË	4,539	4,306	712	778	3,959	4,183

Grafik 5: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve Jo-Jetë



Grafik 6: Pesha e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave



b) Tregu i sigurimeve të Jetës


Në mln Lekë

	Depozita në Lekë		Depozita në USD		Depozita në Euro	
	31.12.2020	30.06.2021	31.12.2020	30.06.2021	31.12.2020	30.06.2021
TREGU JETË	1,708	1,668	78	103	1,006	1,011


Përsa i përket tregut të sigurimit të Jetës, rreth 1.7 miliardë Lekë janë investuar në depozita në Lekë, ose 60% kundrejt totalit të depozitave, ndërsa rreth 1 miliardë Lekë janë investuar në depozita në valutë, ose 40% kundrejt totalit të depozitave.

Në depozitat në valutë të huaj, peshën kryesore e zënë depozitat e investuara në Euro, të cilat arrijnë vlerën rreth 8.2 milionë Euro, ose kundravlerën rreth 1 miliardë Lekë dhe zënë rreth 90.8% të depozitave në valutë dhe 36.4% të depozitave totale. Pjesa tjetër e depozitave janë të investuara në USD. Depozitat në valutë në raport me depozitat totale si raport, kanë pësuar një rritje të lehtë në krahasim me fundin e vitit 2020.

Grafik 7: Vlera e depozitave në Lekë dhe valutë për tregun e sigurimeve të Jetës



Grafik 8: Pesha e depozitave në Lekë dhe në valutë kundrejt totalit të depozitave




B. Tregu i Kapitaleve

Tregu Shqiptar i Kapitaleve, i mbizotëruar nga titujt e borxhit të qeverisë që janë kryesisht në lekë, karakterizohet nga një shkallë tepër e ulët e euroizimit. Pjesëmarrësit kryesorë në këtë treg përdorin kryesisht monedhën vendase. Megjithatë ka edhe emetues privatë të titujve që kanë kryer emetime në valutë. Autoriteti monitoron këtë treg, për të vlerësuar ecurinë e treguesve dhe nevojën për masa specifike.


1. Tregu me pakicë

Të dhënat e tregut me pakicë përfshijnë tregtimin e titujve të borxhit të qeverisë mes bankave të licencuara dhe investitorëve individualë apo personave juridikë, në lekë dhe monedhën Euro. Tregu me pakicë dominohet nga blerjet e bankave në tregun primar për llogari të investitorëve. Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2021 nuk ka patur transaksione në euro.

Grafik 9: Tregu me Pakicë i titujve Qeveritarë




Grafik 10: Tregu me Pakicë i titujve Qeveritarë në %



2. Bursa Shqiptare e Titujve

Në Bursën Shqiptare të Titujve (ALSE), gjatë vitit 2020 dhe gjashtëmujorit të parë vitit 2021 janë realizuar vetëm transaksione në tituj të Qeverisë Shqiptare, të nominuar në lekë.


Grafik 11: Pesha e transaksioneve në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të transaksioneve në Bursën Shqiptare të Titujve




3. Obligacionet me ofertë private

Tregu i kapitaleve iu ofron shoqërive aksionare mundësi për sigurimin e fondeve të financimit për biznesin e tyre. Duke filluar nga dhjetori 2011, emetimi i obligacioneve nëpërmjet ofertave private ka qënë një burim financimi për banka, institucione financiare dhe shoqëri tregtare. Obligacionet janë emtuar në monedhën vendase dhe në valutë të huaj (EUR dhe USD). Totali i shumës së pashlyer të obligacioneve të emtuara nëpërmjet ofertave private në fund të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2021 është: 8,424 milionë lekë, nga të cilat 48.14% janë në Euro (ekuivalenti në lekë 4,055 milionë) dhe 6.43% në USD (ekuivalenti në lekë 542.3 milionë). Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2021 vihet re një rritje e obligacioneve me ofertë private të emtuara në valutë.

Grafik 12: Obligacionet me ofertë private të emtuara dhe të pashlyera



Grafik 13: Pesha e obligacioneve në Lek dhe në valutë kundrejt totalit të obligacioneve me ofertë private të emtuara dhe të pashlyera




C. Tregu i Fondeve të Investimit dhe të Pensioneve


Në 30.06.2021, në tregun e fondeve të investimit operuan nëntë fonde të hapura me ofertë publike, nga të cilët pesë fonde investimi kryejnë veprimtarinë në monedhën vendase Lekë. Tre nga fondet e investimit (dy të licencuara në Tetor 2020) kryejnë të gjithë aktivitetin në monedhën Euro, ndërsa një fond investimi tjetër kryen vetëm investimin e aseteve në monedha të huaja, kryesisht në monedhën Euro.

Asetet neto të Fondeve, të cilët kryejnë të gjithë aktivitetin e tyre në monedhën Euro duke nisur që nga mbledhja e kontributeve të investitorëve, investimet e aseteve të fondit, tarifa e administrimit si dhe shlyerjet ndaj investitorëve, janë rreth 72 mln Euro dhe zënë rreth 12.29% të totalit të aseteve neto të tregut. Edhe detyrimet e këtyre fondeve, të cilat përfaqësojnë detyrimet ndaj shoqërisë administruese për tarifën e administrimit dhe detyrime për pagesat ndaj kuotambajtësit, mbahen përsëri në monedhën Euro dhe zënë rreth 3.22% të detyrimeve të tregut. Asetet neto të fondeve të tjera të investimit, asetet dhe detyrimet e të cilave mbahen në monedhën vendase lekë, janë rreth 63 miliardë Lekë dhe zënë rreth 87.71% të totalit të aseteve neto të tregut.

Gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021, vlera e aseteve neto të fondeve në Euro ka pësuar rritje në krahasim me fundvitin 2020, si rezultat i hyrjes në treg të dy fondeve të reja, por pesha specifike që këto fonde zënë ndaj totalit të aseteve neto të tregut të fondeve të investimit është ulur nga 13.02% në 12.29%.

Grafik 14: Vlera Neto e Aseteve të fondeve të investimit





Sa i përket fondeve të pensioneve vullnetare, ato e kryejnë tërësisht aktivitetin e tyre në lekë.

III. Përfundime

Pesha e vlerës së asetëve që administrohen prej subjekteve të mbikëqyrura nga Autoriteti është relativisht e ulët. Gjithashtu, bazuar në të dhënat e mësipërme, niveli aktual i përdorimit të valutës (Euro-s) në tregjet e mbikëqyrura nga AMF është në nivele përgjithësisht të ulëta dhe i diktuar nga profili i veprimtarisë së institucioneve të mbikëqyrura.

Autoriteti do të monitorojë zhvillimet në këto tregje dhe më konkretisht do të fokusohet në drejtim të rritjes së transparencës për produktet që iu ofrohen investitorëve, veçanërisht në drejtim të evidentimit dhe kuptimit sa më të qartë të rrezikut (të drejtpërdrejtë ose të tërthortë) të kursit të këmbimit.